



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1494 Prot.
15

Patos më 30.05.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 26.05.2025.

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Liljana Mesutaj
2. Erald Çepele
3. Lori Musaj
4. Artan Velçani
5. Klarida Semanjaku
6. Armand Ahmetaj
7. Ertilla Myrtaj
8. Suela Hoxha
9. Smerald Hazizaj
10. Renaldo Shpata
11. Vjollca Kasaj
12. Eduart Faslliaj
13. Novrus Toska
14. Gani Ahmetaj
15. Shezair Sinanaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar anëtar kolegj këshilltarë!

Të nderuar qytetar!

Kjo është mbledhja e radhës e këshillit bashkiak. Mbledhja është e bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53 pika 4 dhe 56 pika 2 gërma a.

Pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit është 15 këshilltarë.

Paraprakisht të nderuar anëtar të këshillit, pjesa e administratës së bashkisë, i nderuar përfaqësues i medias, ju njoftoi se në sallë është dhe një përfaqësues i medias.

Para se të kalojmë në rendin e ditës dua të ndalem një moment te një ngjarje të dhimbshme që na ka prekur të gjithë ne këtu dhe jo vetëm. Kanë kaluar disa javë nga ndarja nga jeta e kolegës tonë

te nderuar znj. Enkelejda Ajazi. Ajo ishte nje ze i angazhuar dhe kontribues ne punen e ketij keshilli dhe do te kujtohet gjithmonë për përkushtimin qytetarinë dhe integritetin e saj.
I paharruar kujtmi saj!

Kalojmë në rendin e ditës.

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.04.2025.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28.04.2025.
- 4- Për deklarin e mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Patos”.
- 5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Prill 2024”.
- 6- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Prill 2024”.
- 7- Projekt-vendim “Për miratimin e projektit me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Sotir Capo” dhe ndërtimi i palestrës” dhe bashkëfinancim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit”.
- 8- Projekt-vendim “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2025 për mbrojtjen civile për rehabilitimin e Përroit në lagjen e Re, Faza II-të dhe Përroit Dukas”.
- 9- Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së një mjeti traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese në territorin e bashkisë Patos”.
- 10- Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2025.

Para se të kalojmë në votimin e rendit të ditës ka dy kërkesa nga ekzekutivi për të shtuar në rendin e ditës

Një e cila ka kaluar në komisionin e ekonomisë.

1- Projekt-vendim “Për ndryshim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 83, datë 27.11.2024, “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025”.

2- Projekt-vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në kuadër të grantit dhe performancës për “Planin e Arsimit Parauniversitar dhe Plani i Barazisë Gjimore” të lidhura midis Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe Bashkisë Patos”.

Paraprakisht para se të miratojmë rendin e ditës do miratojmë këto dy pika e cila kërkon 2/3 e votave.

Kush është dakord për shtimin e këtyre dy pikave?

15 vota pro abstenim ska, kundër ska. Miratohet

Vazhdojmë në leximin e rendit të ditës

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.04.2025.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28.04.2025.
- 4- Për deklarin e mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Patos”.
- 5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Prill 2024”.
- 6- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Prill 2024”.
- 7- Projekt-vendim “Për miratimin e projektit me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Sotir Capo” dhe ndërtimi i palestrës” dhe bashkëfinancim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit”.
- 8- Projekt-vendim “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2025 për mbrojtjen civile për rehabilitimin e Përroit në lagjen e Re, Faza II-të dhe Përroit Dukas”.
- 9- Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së një mjeti traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese në territorin e bashkisë Patos”.
- 10- Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2025.

11- Projekt-vendim "Për ndryshim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 83, datë 27.11.2024, "Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025".

12- Projekt-vendim "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në kuadër të grantit dhe performancës për "Planin e Arsimit Parauniversitar dhe Plani i Barazisë Gjinore" të lidhura midis Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe Bashkisë Patos".

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendin e ditës ?

Miratohet me 15 vota pro abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba




Smerda Hoxhi



KRYETAR

Armand Ahmetaj



Eduart Foshtaj



Renata Shkurtaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1494 Prot.
16

Patos më 30.05.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.04.2025

Armand Ahmetaj – Jeni njohur me materialin, kemi ndonje verejtje? Nëse s'keni miratohet procesverbali i datës 28.04.2025.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smergjet Hoxha
[Signature]

KRYETAR
Armand Ahmetaj

[Signature]

Ednart Foshtaj
[Signature]

[Signature]

Remzeta Shybe
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1494 Prot.

Patos më, 30 05.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28.04.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 28.04.2025 janë marrë gjithsej 2 vendime. Nga nr. 18 deri në nr 19.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Smerdet Hoxha

Edmar Fasllis

Rendola Shyti

Refaela Xeba



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 14581 Prot.

Patos më 30 05.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Për deklarinimin e mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Patos”.

Armand Ahmetaj- Ju njoftoj se në datën 15.05.2025 komisioni i mandateve është mbledhur mbasi kanë marrë dijeni zyrtarisht vdekjen e koleges sonë dhe ka dalë më propozimin

Propozimin për këshillin bashkiak të miratoj përfundimin e mandatit të znj. Enkelejda Ajazi dhe nisjen e procedurave përkatëse për zëvendësimin e vendit vakant.
Armand Ahmetaj – Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARË

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1462 Prot.
13

Patos më 30 05.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Prill 2024”.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social-Përshëndetje! Projekt-vendim nr. 22 datë 16.05.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Prill 2024”. Ekzekutivi propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Prill 2025 gjithsej 19 familje me një fond prej 73,200 (shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Eduart Faslliaj- Krahasuar me muajin e kaluar ka ndonjë shtesë? Kush janë personat dhe njëkohësisht dhe arsyen?

Elda Goxhaj- Këtu duhet të ishin koleget që punojnë me sistemin por unë gjithsesi kam shënimet përkatëse.

Personat që kanë hyr janë: Dritan Fetahu, Lubjana pëllumbi, Marjeta Dhanaj, Liri Muskaj, Nazerina Resuli, Dashnor Meraj.

Eduart Faslliaj- Të rezulton që këta janë personat që kanë hyr shtesë?

Elda Goxhaj- Po këto janë shënimet që unë kam marrë nga koleget që punojnë direkt me sistemin. Nëse do informacion specifik mund ti thërrasim

Eduart Faslliaj- Albano Fiqiriu ka qënë në listën e kaluar? Apo është shtesë?

Elda Goxhaj- Nuk e kam listën e muajit të kaluar me vete.

Eduart Faslliaj- Po atëherë si i nxjerë që këta janë persona që janë shtesë?

Kemi një listë të personave që kanë marrë këtë pagesën nga muaji i kaluar, për këtë muajin tjetër kjo lista e re ka shtesë emrash?

Elda Goxhaj- Po flasim për listën e përfituesve të muajit prill që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga sistemi dhe kanë kaluar nga të ardhurat e bashkisë.

Eduart Faslliaj- Në ndryshim nga muaj Mars a ka shtesa?

Elda Goxhaj- Nuk e kam listën e muajit Mars me vete.

Eduart Faslliaj- Kush mund tma japi këtë përgjigje?

Armand Ahmetaj- Elda mund të japi përgjigje për listën e tanishme, e cila është konform ligjit. Nëse të duhet informacion për të kaluarën ne marrim kohën e duhur, Elda zbret e merr informacionin dhe mund ta japi.

Eduart Faslliaj- Për çfarë mbliidhemi ne kur nuk marrim përgjigje për kaq pak.

Elda Goxhaj- Ne nuk mund të mbajmë mend gjithë emrat e përfituesve por mund të zbres poshtë dhe të nxjer listën krahasuese nga sistemi ose nga vendimi i këshillit që tashmë është i zbardhur.

Eduart Faslliaj – Dakord por referuar kësaj unë kisha qëndrimin tim për ta miratuar ose jo sepse në bindjen time mesa unë mbaj mend duhet të këtë shtesë të personave që unë dyshoj se kanë qënë qok

politike sepse ne kete rastin e interpretimit te fondeve te kushtezuar qe vjen nga bashkia nuk eshte nje standard siq perdoret per fondin.

Elda Goxhaj- Po flasim per te ardhurat.

Eduart Faslliaj- Ne ndryshim nga ato qe jane standard, qe i nxjerr sistemi kujt i takon dhe kujt si takon, kjo lista qe po miratojmë ose qe po na vjen tani per miratim është çështje interpretimi qe bëhet nga ju si institucion.

Elda Goxhaj- Nuk është çështje interpretimi se ata e kanë bërë aplikimin në sistem dhe të dhënat gjenerohen nga sistemi.

Eduart Faslliaj- Po pra por sistemi i ka përjashtuar këta dhe i ka ngelur për interpretim ekzekutivit.

Elda Goxhaj- Ekzekutivi ka vullnetin për ti ndihmuar.

Eduart Faslliaj- Unë gjykoj qe atë të drejtë qe u jep ligji ju nuk duhet ta përdorni për interesa të tjera, unë gjykoj qe në këtë rast është përdorur për një gjë tjetër dhe nuk mund të vij një person kryetar qe nuk është kompetent dhe tme thojë qe unë nuk e kam një përgjigje. Këtu duhet të vij personi përkatës qe tna kthej përgjigje dhe të mos marrim kohën kot.

Në bindjen time këtu janë shtuar persona qe nuk ju takon, qe interpretimi për tju dhënë këtë ndihmën nga pushteti lokal është një qok politike qe perdoret si shpërblim mbas zgjedhjeve prandaj dhe unë po deklaroj votën time kundër.

Nëse do ishte një person qe konkretisht do kishim folur për emra konkret, për sa kohë zonja më thotë se nuk jam unë personi qe të them se kush ka qënë dhe kush është shtuar unë nuk kam çfarë të them.

Armand Ahmetaj- Po nuk mund të flisni në hava pra.

Eduart Faslliaj- nuk po flas në hava, unë përmenda një emer dhe të thash ka qënë ose jo dhe nuk pata një përgjigje.

Armand Ahmetaj- Elda të lutem përgjigja duhet të jetë shteruese, pastaj ne nuk mund të kërkojmë kush ishte dhe kush nuk ishte. Ti mund të kerkosh cili është detyrimi ligjor dhe ku e kanë shkelur sipas mendimit tënd ekzekutivi.

Eduart Faslliaj- Kur vihet zakonisht kështu thuhet qe kemi këtë listën dhe kur nuk kanë ndryshim ska vend as për diskutime. Gjithmonë kur shtohen thuhet qe janë shtuar këta persona dhe ka qënë kjo arsyeja dhe pyetja ime kjo ishte, a janë shtuar persona dhe kush janë këta persona?

Elda Goxhaj- Unë ti lexova të gjashtë personat.

Armand Ahmetaj – Unë mendoj se nuk janë fiks, kështu qe të jemi korrekt duhet tme japësh listën e parë.

Elda Goxhaj- Personat qe janë shtuar unë jua lexova dhe unë mbaj përgjegjësi për këta persona.

Armand Ahmetaj- Elda të lutem kush janë personat qe janë shtuar?

Elda Goxhaj- Dritan Fetahu, Lubjana Pëllumbi, Marjeta Dhanaj, Liri Muskaj, Nazerina Resuli, Dashnor Meraj

Zv/ Kryetare Ina Sauli – kemi para listën e muajit Mars dhe është shtuar vetëm një emer.

Armand Ahmetaj- Nga muaj mars deri ne prill ka vetëm një ndryshim, një emër?

Zv/ Kryetare Ina Sauli – Po

Armanda Ahmetaj- Cili është emri

Zv/ Kryetare Ina Sauli - Marjeta Dhanaj kryefamiljare e papunë me një fëmijë të mitur.

Lori Musaj- Komisioni i Ekonomisë është mbledhur në datën 23 ditën e premtë dhe ka diskutuar mbi këtë projektvendim. Komisioni ekonomisë pasi shqyrtoi kërkesën e mësipërme konstaton se përmbajtja e projektvendit është në përputhje me bazën ligjore dhe kemi vendosur ta miratojmë pas një ndryshim duke votuar me 3 vota pro.

Armand Ahmetaj – Nëse s'kemi pyetje të tjera kalojmë në miratim. Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin? Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Prill 2024”.

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, 1 kundër.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1468 Prot.
13

Patos më 30.05.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Prill 2024”.

Armand Ahmetaj- Ftojmë ekzekutivin.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social- Projekt-vendim nr. 23 datë 16.05.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Prill 2024”.

Ekzekutivi propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Prill 2025 gjithsej 17 familje me një fond prej 68,447 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dyzetë e shtatë) lekë. Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Masa e pagesës për familjet përfituese të jetë sipas V.K.M.

Lori Musaj- Gjatë mbledhjes së komisionit të ekonomisë është diskutuar në ky projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi votuar me 3 vota pro.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Prill 2024”.

Miratohet me 15 vota pro, asnjë kundër , abstenim ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 14631 / 13 Prot.

Patos më 30 05.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e projektit me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Sotir Capo” dhe ndërtimi i palestrës” dhe bashkëfinancim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit”.

Ermenita Mici - Projekt-vendim për rikonstruksionin e shkollës Sotir Capo dhe ndërtimin e palestrës ka të bëjë me aplikimin që është bërë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të cilat kanë miratuar bashkëfinancimin e këtij projekti.

Bashkëfinancimi i këtij projekti do jetë në masën 85% të nga Ministria e Arsimit dhe 15% do të mbulohet nga bashkia Patos, godina në të cilën aktualisht zhvillohet mësimi është në gjendje totalisht të amortizuar dhe projekti ndërhyrjes për këto objekt përfshijnë rikonstruksionin e plotë të tij duke filluar që nga punimet e rifiniturës, zëvendësimin e dyerve dritareve instalime të reja të rrjetit elektrik, instalime të mbrojtjes nga zjarri të sistemit audios, gjithashtu dhe ndërtimin e një palestër në pjesën e pasme të objektit po ashtu do kemi dhe një rikonceptim të oborrit meqënëse në këtë shkollë kemi të përfshira tre grupmosha të ndryshme gjithashtu të inkuoruar dhe një kopsht. Përsa i takon këtij objekti i kërkojmë këshillit të bashkisë të miratojë bashkëfinancimin e projektit e cila i referohet 85% të vlerës totalit të punimeve referuar preventivit të objektit që do të mbulohet nga Ministria e Arsimit dhe 15% të mbulohet nga bashkia Patos me cikël financimi dy vjeçar.

Armand Ahmetaj – Fjalën e ka komisioni i ekonomisë.

Lori Musaj- Edhe kjo pikë është diskutuar në mbledhjen e komisionit të ekonomisë i cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore ndaj kemi votuar me katër vota pro, mar shkas që të japë përgëzimet e mia ekzekutivit për punën e bashkisë së duke bërë këtë projekt që ata fëmijë përfitojnë në shkollën dhe kushtet të reja që do ketë.

Eduart Faslliaj – famijët e kopshtit të kësaj zone deri më përpara kishin një godinë ku shkonin në kopsht aty në fshat diku tjetër dhe numri i fëmijëve që shkojnë në kopsht krahasuar me vitin e kaluar po me dy vjet përpara ishte rritur apo është ulur?

Ermenita Mici- besoj se këto të dhëna i takojnë më shumë programit të arsimit sepse ne po flasim për rikonstruksionin e shkollës tani të them unë për dijeni time janë 20 nxënës tek pjesa e kopshtit dhe 200 e ca nxënës tek pjesa e shkollës por besoj që nuk lidhet direkt me projektvendimin kjo pyetje.

Eduart Faslliaj – Kur të pyeta e kisha një qëllim nuk të pyeta kot megjithatë mbase nuk je personi përkatës dhe nuk ke një përgjigje fiks, këta fëmijë që do inkuorohet kopshti në ambientet e shkollës ku shkonin më përpara në atë vend atë fshat shkonin apo shkonin diku larg?

Ermenita Mici – po kopshti është pjesë e një inkuoruar të godinës në pjesën e djathtë të tij është aktualisht dhe do qëndroi aty.

Erald Çepele – Si anëtar i këshillit që mbuloi njësinë Zharrëz duhet ta përgëzoj këtë si projekt pasi ka më shumë se dhjetë vjet që kur ndodhn lëkundjet që ka pësuar dhe dëmtime si objekt është një gjë e mirë unë kisha vetëm dy pyetje lidhur me projektin, është përfshirë sistemi ngrohjes dhe shkallë të emergjencës përveç palestrës?

Ermenita Mici – po sepse pjesërisht ekzistojnë shkallët e emergjencës në pjesën e djathtë të objektit dhe do shikohet mundësia për të përshtatur për të gjithë objektin.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord? Kalojmë në votimin e ikës së shtatë Projekt-vendim “Për miratimin e projektit me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Sotir Capo” dhe ndërtimi i palestrës” dhe bashkëfinancim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit”.

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Armand Ahmetaj

Refaela

Shpresa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1464 Prot.

Patos më 30.05.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2025 për mbrojtjen civile për rehabilitimin e Përroit në lagjen e Re, Faza II-të dhe Përroit Dukas”.

Ekzekutivi relaton materailin.

Ermenita Mici – Si çdo vit Ministria e Mbrojtjes në programin e emergjencave civile akordon një fond të caktuar i cili ju shpërndahet më pas njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Për këtë vit, ër vitin 2025 bashkisë Patos i është dhënë vlera prej 5 milionë e 45 mijë e 349.

Kjo vlerë shpërndahet në dy programe që ka të bëjë programi i parë me marrjen e masave parandaluese lehtësuese e cila nga ana e bashkisë Patos është parashikuar ti kalohet vlera prej 5 milionë lekë që do shërbejë për rehabilitimin e Përroit në lagjen e Re dhe Përroi Dukas ndërsa për programin e dytë është parashikuar pjesa e mbetur e cila do të përdoret për rastin e ndihmës të banorëve të cilat të shtëpitë e tyre mund të dëmtohen në rastin ndonjë fatkeqësie të ndryshme.

Për sa i përket programit të cilin të ne kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi që ka të bëjë me rehabilitimin e prroit ka për qëllim që të rehabilitojë pjesën e mbetur të përroit në lagjen e Re që ka një gjatësi prej 150m linearë i cili do të vazhdojë dhe të mbyll komplet pjesën e gjurmës së tij në territorin e bashkisë Patos dhe përroit Dukas i cili po ashtu dhe ky me një gjatësi prej 150 m linear do të fillojë faza e parë e rehabilitimit dhe veshja me beton.

Në këto kushte kërkojmë miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për vitin 2025 për mbrojtjen civile për projektin rehabilitim të përroit në lagjen e re faza e dytë dhe përroi Dukas me vlerë 5 milion leke.

Lori Musaj- Komisioni ekonomisë diskutoi mbi këtë projektvendim dhe vendosi ta miratoi me katër vota pro.

Eduart Faslliaj – Për pjesën tjetër të fondit që ka kaluar tek Përroi në Dukas dhe mesa kam folur me zonjën ishte ai segmenti nga ura dhe sipër a janë marrë në konsideratë kur është përzgjedhur që të bëhet ky segment se mbase ka pasur gjëra tjera me emergjente.

Unë vij nga zona Patosi vjetër përfaqësuesi asaj zone dhe në dijeni time të gjithë komunitetit atje është ajo e vogël përpara se të vesh te rruga që lidh atosin e ri me Patosin e vjetër përpara se të vesh të kthesa e fortë që ka një lëvizje tektonike dhe që paraqet edhe një rrezikshmëri të madhe për gjithë automjetet që lëvizin aty.

Kush ka qenë kriteret që ta përmbledh pyetjen që është përzgjedhur ky segment për të kaluar fondi dhe meqenëse jemi këtu dhe kemi zonja nënkryetare do doja se në dijeni time është miratuar buxheti për shtrimin e rrugës Patosi ri Patosi vjetër në qoftë se është e vërtetë kjo si lajm sepse informacion zyrtar nuk kemi kur fillojnë punimet?

Ermenita Mici – e thotë vet programi marrja e masave parandaluese lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme kështu që duke ju referuar vlerës së mbetur nga kryerja punimeve nga preventivi i punimeve për segmentin e përroit Çam atëherë u përzgjedhë që me pjesën e mbetur të vlerës të investohet tek përroi Dukas.

Dhe ai objekt që ju përmendet dhe që diskutuam edhe herën e parë me këtë vlerë që mbetet nuk mund të realizohet dhe besoj se kjo është e qartë për pjesën tjetër që pyesni për pjesën e rrugës edhe për këtë ju ktheva një përgjigje në ditën kur ishte komisioni dhe nuk ka lidhje me projektvendimin kështu që besoj që nëqoftëse në momentin ku ajo do fillojë do kemi një përgjigje do kaloj një projektvendim do kemi një shpallje, do njoftohet në rrjetet sociale dhe do jemi të qartë të gjithë banorët.

Eduart Faslliaj- Meqënëse zonja më tha se sasia e lekëve përkonte me përlllogaritjen që do shpenzimi për të bërë të pjesa e përroit Dukas jeni ju në dijeni për këtë problematikë që ka rruga aty tek shkarja kësaj ure dhe keni bërë një përlllogaritje sesa shkon kostoja për rehabilitimin e problemit?

Ermenita Mici- tani ishte e qartë besoj që është vetëm 150m metra linearë segment që të bëhet nga përroi Dukas ne mund të jemi në dijeni të shumë problematikave por që nuk kanë lidhje me këtë projektvendim dhe me këtë fond se kjo është përzgjedhur për këtë projektvendim dhe ju jeni dakord atëherë do votoni pro ose kundër për pjesën tjetër nuk di ç'a të them.

Eduart Faslliaj- Unë të falenderoj që na tregove se kush është detyra jonë por një pyetje tjetër kisha megjithatë kjo është rruga që ju zgjodhët për të kthyer përgjigje

Faleminderit!

Armand Ahmetaj- doja të shtoja diçka tek fjala e Ermrenitës, mendoj se është përzgjedhur sepse paktën dy pika ka qenë vatrë infeksioni dhe janë pranë banesave është një pikë në Grizë Gropallare e cila sot po mbulohet me tumbino, është dhe kjo pikë në Dukas siç e tha dhe specialistja paraqet pothuajse të njëjtën rrezikshmëri për shëndetin e njerëzve llogarisim shëndetin e njerëzve.

Zv/ Kryetarja Ina Sauli - Për sa i përket segmentit që pyetët më parë ajo është përfshirë në marrëveshje me FSHZH dhe kemi firmosur kontratën dhe presim informacionin që do vi, se si do vijoj dhe kur do nis puna nga Fondi Zhvillimit Shqiptar.

Eduart Faslliaj- A ka afate kohor nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes se sa kohë zgjat?

Zv/ Kryetarja Ina Sauli - Jo nuk e caktojnë.

Eduart Faslliaj- Ka marrë formë definitive? Do ekzekutohet si investim?

Zv/ Kryetarja Ina Sauli - Është firmosur kontrata.

Kalojmë në votimin e pikës së tetë Projekt-vendim "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2025 për mbrojtjen civile për rehabilitimin e Përroit në lagjen e Re, Faza II-të dhe Përroit Dukas".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

Smirëlda Hoxhi

SEKRETARE

Refaela Xeba

Refaela Xeba

Eduart Faslliaj

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1465 Prot.

Patos më 30.05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së një mjeti traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese në territorin e bashkisë Patos”.

Ermenita Mici- Për blerjen e këtij mjeti është aplikuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të cilat kanë shpallur thirrjen me objekt blerjen e automjeteve me përdorim të veçantë. Nga ana e bashkisë Patos është aplikuar në këtë thirrje për vlerën e një traktori dhe një freze. Ky mjet synojmë ti shërbejë të gjithë komunitetit kryesisht të për pastrimin e kanaleve kulluese apo për pastrimin e bimësisë që do i vijnë në ndihmë kryesisht fermerëve por besoj dhe më gjerë. Me anë të këtij aplikimi ne kemi miratuar vlerën prej 12 milion lekë për blerjen e këtij automjeti dhe i kërkojmë këshillit të bashkisë që të miratojë blerjen e mjetit traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese me vlerë 12 milionë lekë e cila do të financohet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Faleminderit!

Novrus Toska- Ky vjen mjet i ri apo është i përdorur?

Ermenita Mici- të them të drejtën për këtë pjesë nuk e di specifikisht nëse është i ri apo i përdorur por besoj që persona që janë marrë me studimin e tregut në lidhje me automjete kanë marrë një referencë të caktuar nuk e di nëse bëhet fjalë për të ri apo për të përdorur.

Novrus Toska- Më vjen mirë që bashkia rrit flotën në sajë të mjeteve të punës por di që para tre vjetësh është blerë edhe një frezë tjetër për prerjen e këtyre barishteve mbeturinave të rrugës anës rrugë është gjendje punë kjo ka punuar ndonjëherë si frezë.

Ermenita Mici - Nuk kam informacion për këtë realisht mbase do të pyesim pjesën e agjencisë, nuk kam dijeni.

Novrus Toska- Mendoj se këshilli ka nevojë për një informacion për shkallë e shfrytëzimit të mjeteve që kanë sot në flotën e tij.

Armand Ahmetaj -është e pamundur që të japim përgjigje për muajt e kaluar apo për probleme, ne nuk i kemi thirrur specialistët të cilët janë këtu për rendin e ditës jemi jashtë rendit ditës me këtë pyetje edhe do na duhet kohë, nuk merret me inventarin Ermenita.

Novrus Toska- Mua më vjen mirë por kam edhe këtë sygjërim që ne duhet të kërkojmë këto.

Armand Ahmetaj – sekretare këshillit në këtë rast po e regjistron si kërkesë dhe do të kesh përgjigje.

Suela Hoxhaj- A është publikuar ky lloj projektvendimi në konsultime publike apo në dëgjesa publike paraprakisht dhe është diskutuar me grupet e interesit konkretisht fermerët apo bordin e kullimit pasi edhe nëse është konsultuar me ata padiskutim është një gjë më e rëndësi për ta ditur edhe ne.

Armand Ahmetaj – Me grupet e interesit nuk ka lidhje fare jo por për dijeni në të gjitha degjesat ne marrim kërkesa të vazhdueshme nga të treja njësitë, pjesë e këtyre kërkesave ka qenë dhe ky ë traktor për nevojat gjatë gjithë njësive që e kemi pjesën rurale.

Zv/ Kryetarja Ina Sauli -Doja të shtoja dhe që kjo është thirrje e hapur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe në aplikojmë për këto projekte për ti përfituar edhe normalisht në varësi të nevojave që kemi apo mangësive që kemi në flotën tonë apo vështirësive që hasim në Agjencinë e Shërbimeve Publike për të ardhur ndihmë të gjithë qytetarëve apo dhe territorit për ta pastruar ose për të bërë punën e nevojshme është parë e udhës që të ishte ky mjeti .

Suela Hoxhaj- realisht për të përdorur këtë fond bashkia Patos është e vendosur në një terren kundrinor por njëkohësisht njësia Zharrëz është fushor dhe ky mjet mund të përdoret aty, jam shumë dakord po ndërkohë ne përballemi jo vetëm me përmytje por edhe tërmete për shembull një tërmet ka ndodhur disa vite më parë.

Armand Ahmetaj –është e qartë në relacion Suela është për bashkinë Patos nuk është vetëm për Zharrën. është për bashkinë Patosi cila përfshihen të treja njësitë.

Suela Hoxhaj- Po pra a nuk është konsultuar më parë kjo gjë sepse përmytje ne në dekadën e fundit nuk kemi pasur atëherë kështu që mjeti që është përdorur tanl është e drejtë domethënë cili është më emergjentë?

Zv/ Kryetarja Ina Sauli- Thirrja është blerja e automjeteve për përdorim të veçantë makinat teknologjike dhe mjete rrugore të veçanta të përcaktuara si të tilla kjo ishte titulli i thirrjes.

Erald Çepele- Duke qënë se unë kam qënë një nga propozuesit e këtij mjeti për blerjen e këtij mjeti dhe kam votuar dhe kundra një investimi tjetër për të marrë këtë investim për të blerë këtë makineri dhe nga ana e kryetarit është premtuar që ne do të aplikojmë tek agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është e njëjta gjë siç rasti që ka blerë qeveria skrepat para disa viteve për bashkitë për përmytjen për kanalet kurse ky mjet është specifik kryesisht për njësinë Zharrëz por jo vetëm i vijnë ndihmë të gjithë jo vetëm rrugëve kryesore por dhe parcelave bujqësore është në dijeni time është teknologjike është me krahë me goma, besoj duhet të jetë i ri patjetër është mjet me krahë që paston jo vetëm bankinat por edhe ferrat.

Unë e përgëzoj dhe ju ftoj ta votoni.

Eduart Faslliaj- Ky është fond që i vjen bashkisë dhe bashkia bën blerjen?

Ermenita Mici- Është thirrje për aplikim që ne aplikojmë dhe ka kriterë të caktuara, vjen fond, vlerë në lekë.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për pikën nëntë? Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së një mjeti traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese në territorin e bashkisë Patos”.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1466/1 Prot.

Patos më 30.05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

10- Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2025.

Mimoza Shëmbari- Dr Financës- Ashtu siç ju jeni informuar çdo katërmujor ekzekutivi raporton mbi zbatimin e buxhetit dhe ecurinë e monitorimit të treguesve në këtë raport monitorimi kemi paraqitur treguesit financiarë të realizimit të buxhetit për vitin 2025 i cili ka qëllimin dhe orientimet dhe prioritetet e miratuara si bazë kryesore.

Burimet e këtij buxheti gjatë katërmujorit të parë të vitit 2025 përbëhet nga buxheti fillestar i cili është miratuar me vendim këshillit 87 dhe përmban vlerën 676 milionë lekë i cili është shtuar me vendim të këshillit numër 3 me buxhetin me fondet e trashëguara me vlerë 278 milion e 819 mijë dhe në total buxheti për vitin 2025 sipas burimeve të cilat janë objekti miratimit me vendin këshilli përbën 955,485,779 lekë

Në tabelat e paraqitura në raportin e monitorimit keni dhe paraqitjen financiare të burimeve sipas burimeve të financimi të cilat janë transferta e pa kushtëzuar që është granti që për vitin 2025 me buxhet fillestar zë vlerën 228 milion 071 mijë lekë me buxhet të trashëguar nga fondet e papërdorura për vitin 2024, 86 milion në total 314 milion.

Në katërmujorin e parë është realizuar 59%.

Kemi të ardhura nga transferta sektoriale që mbulon pesë funksione të cilat janë transferuar me vendim këshilli ministrave dhe në total fonde të trashëguara plus buxhet fillestarë përbën vlerën 185 milion deri në katërmujorin e parë, kemi realizuar 37%.

Të ardhurat vendore planifikuara janë 312 milion e 582 mijë lekë

Të realizuara 31 milion 560 mijë lekë ose 10% të ardhurat të trashëguara 143 milion të cilat janë vazhdojnë financimet e vitit 2024 të paralizuar për likuidim por jo të paralizuar janë të lidhura kontrata dhe vazhdojnë të realizohen sepse grafiku punimeve është shtrirë përtej vitit 2024.

Kemi dhe fondet e kushtëzuara që nuk janë objekt i miratimit të këshillit që zen deri në katërmujorin e parë 330 milion janë realizuar 94% ose 29%.

Gjatë katërmujorit të parë me vendim këshilli nuk kemi ndryshime të buxhetit të vitit 2025 referuar tabelave të raportit të monitorimit keni dhe përqindjen e realizimit të të ardhura sipas elementëve të tatimit taksave dhe tarifave.

Dihet që ky 4 mujor nuk ka tregues të kënaqshëm sepse ka qenë edhe fillimi i vitit edhe vit zgjedhor që kishte kufizimet e veta referuar tabelave të raportit të monitorimit të shpenzimeve sipas programeve i keni të referuara të tabela numër 3 përqindjen e realizimit për çdo program për të dy njësi shpenzuese për bashkinë dhe agjencinë e shërbimeve publike dhe në total realizimi buxhetit është 153 milion 640 mijë ose 23%.

Po ti referohemi shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik kemi në realizimin prej 153 milion 640 mijë 73% shpenzime personeli, 18% shpenzime korrente dhe 9% shpenzime kapitale.

Në tabelën numër 5 janë paraqitur të gjitha investimet dhe statusi ose faza në cilën ndodhet deri në katërmujorin e parë të periudhës që po flasim.

Objekt pas objekti është edhe faza në të cilën ndodhet ose vlera e likujduar në qoftëse është likujduar pjesërisht.

Kemi të paprekur akoma fondin për mbrojtjen civile që është miratuar nga buxheti I të ardhurave vendore kontigjencën dhe rezervë.

Ashtu siç folëm dhe për projektvendimet që u miratuan më përpara jemi në fazën kur na është çelur financimi për vitin 2025 për Sotir Çapo që quhet transfertë e kushtëzuar është çelur pjesa e financimit traktorët plus frezë nga mbrojtja civile 5 milion e 45 mijë kemi dhe nga fondet e kushtëzuara që ne i kemi në administrim fondet e gjendjes civile të gjitha këto dhe ujësjellësi loti i dytë me 202 milion që vazhdon që duhet të jetë viti final për 2025.

Në total fondet e kushtëzuara janë 330 milion e 981 mijë dhe janë realizuar 94 milion 763 mijë. Referuar tabelës së fundit të raportit të monitorimeve ku janë përmbledhur të gjitha aktivitetet dhe kostot e aktiviteteve treguese financiarë për gjithë këto programe dhe aktivitete janë pasqyruar në tabelën e fundit të treguesit financiarë sipas raporteve të ndryshme që shprehen në këtë tabelë hap pas hapi të cilat tregojnë raportet e shpenzimeve ndaj të ardhurave, raportet e shpenzimeve kapitale, ndaj të ardhurave të përgjithshme, shpenzimeve personelit ndaj të ardhurave të përgjithshme huamarrje, detyrime tatimore ose detyrimet ndaj të tretëve, të të gjitha këto janë të reflektuara në tabelën e fundit të treguesve financiarë të këtij raportit në mënyrë të përmbledhur kjo ishte raporti monitorimi të buxhetit për katërmujorin e parë i cili publikohet dhe është në faqen e bashkisë.

SEKRETARE


Refaela Xeba



Edmond Forliseri
Smerolaj Hoxhi


KRYETAR

Armand Ahmetaj



Rendita Shyreta 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Patos më 30.05.2024.

Nr. 1519 Prot.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për ndryshim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 83, datë 27.11.2024, “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025”.

Juela Shpata – Paraqesim sot projekt-vendim nr. 24 datë 20.05.2025 “Për ndryshim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 83, datë 27.11.2024, “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025”.

Bashkëlidhur projektvendimit ndodhet lidhja nr. 1 mbi të gjitha pozicionet që do të përfitojnë ndryshim të nivelit të pagave

Bazuar dhe në VKM e cila ka marrë ndryshim në muajin shtator të vitit 2024 si dhe referuar ngarkesës në punë të përgjegjësisë të anës teknike të disa prej pozicione në Agjencinë e Shërbimeve Publike kërkojmë ndryshimin e disa prej këtyre kategorive. Përfituesi do të jenë vetëm dy punonjës dy pozicione pune nga administrata e Agjencisë së Shërbimeve Publike, pjesa tjetër është nivel punëtorësh Efekti-financiar për këto ndryshime është në vlerën 797 mijë dhe do të fillojnë nga data 01.05.2025. Ky efekt financiar do të përballohet brenda fondit të planifikuar të pagave për vitin 2025 në pozicionet e parealizuara.

Lori Musaj- Në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar gjatë me ekzekutivin në lidhje me të projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe ne kemi vendosur ta miratojmë pas një ndryshim duke votuar me tre vota pro dhe një kundër, vota kundër ishte e kolegut të opozitës i cili i ka kërkuar ekzekutivit që të ketë një shpërndarje më të mirë të fondit në kategoritë e caktuara.

Eduart Faslliaj- Meqenëse jemi këtu dhe zonja kryetare e komisionit e dha sqarimin përkatës dhe diskutuam me ekzekutivin dhe mendimi ishte të kishte një shpërndarje më të mirë të këtij fondit në raportin midis pjesës së administratës që Juela tha që janë vetëm dy persona dhe pjesës punëtoresh unë do të doja të kishte një shpërndarje më të mirë sepse mendoj që ngarkesa e punës është e madhe tek punonjësit dhe duhet të ishte parë kjo lloj kategorie çik më shumë. Kur të bëhej shpërndarja e këtij fondi të merreshin çik më shumë në konsideratë pjesa punëtorëve dhe meqenëse jemi këtu kisha një pyetje Juela kush është raporti midis pagës që përfitojnë këta dy punonjësit e administratës dhe pjesës tjetër që ngelet për tu shpërndarë punëtorëve?

Juela Shpata- një pjesë e punëtorëve të Agjencisë së Shërbimeve Publike në i kemi prekur në dhjetor një pjesë tani dhe një pjesë për vonë të gjitha gradualisht pak më pak mirëpo punëtorët që keni këtu në projektvendim sot kanë marrë dhe gjithë maksimalen aq është hapësira ligjore nuk të lejon më shumë dhe të duam më shumë që të japim por aq është hapësira ligjore.

Eduart Faslliaj- Sa është sasia që përfitojnë këta dy specialistët dhe sa është pjesa që i ngelet punëtorëve?

Erald Çepele -797 mijë lekë.

Juela Shpata- 13 mijë lekë përfiton rritje një nga specialistët .

Eduart Faslliaj- Dmth 10% të fondit e përfitojnë këta dy punonjësit e administratës dhe 90% pjesa e punonjësve.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për pikën njëmbëdhjetë? Projekt-vendim “Për ndryshim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 83, datë 27.11.2024, “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025”.

Miratohet me 14 vota pro 1 kundër ska, abstenim ska,.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Smerolol. Hozirza

Eduart Faslliaj

Remelbo Shroko



KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 178 Prot.

Patos më 30.05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.05.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në kuadër të grantit dhe performancës për “Planin e Arsimit Parauniversitar dhe Plani i Barazisë Gjinore” të lidhura midis Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe Bashkisë Patos”.

Elda Goxhaj- Projekt-vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në kuadër të grantit dhe performancës për “Planin e Arsimit Parauniversitar dhe Plani i Barazisë Gjinore” të lidhura midis Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe Bashkisë Patos”. Në përmbushje detyrimeve ligjore për hartimin e planeve lokaleve në kuadër të grantit të performancës dedikuar bashkive, Bashkia Patos shpreh angazhimin për hartimin e këtyre dokumenteve strategjik ekspertiza e të cilëve ofrohet nga Shoqata Kombëtare e Bashkive e cila do të mbulojë 70% koston financiare të planit, ndërsa 30% do të mbulohet nga bashkia Patos.

Kjo marrëveshje përfshin hartimin e këtyre të dokumentave strategjike:

Planin e Arsimit Parauniversitar

Planin e Barazisë Gjinore

Shërbimi ekspertizës së ofruar nga shoqata do të përfshijë analizë, draftimin dhe konsultimin e objektivave strategjik

Mbështetjen dhe planifikimin e burimeve financiare

Detajimi në aktiviteteve dhe projekteve

Detajimin e masave për përmirësimin e arsimit dhe shërbimit social në Bashkinë Patos

Përsa më sipër kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në kuadër të grantit të performancës për “Planin e Arsimit Parauniversitar” dhe “Plani i Barazisë Gjinore” të lidhur midis Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe Bashkisë Patos.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për pikën dyëmbëdhjetë? Projekt-vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në kuadër të grantit dhe performancës për “Planin e Arsimit Parauniversitar dhe Plani i Barazisë Gjinore” të lidhura midis Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe Bashkisë Patos”.

Miratohet me 15 vota pro kundër ska, abstenim ska..

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smend. Hoxhaj
Edmond Forlligj
Bendito Shkete

KRYETAR
Armand Ahmetaj